

## **INTERESI MË I LARTË (MADHOR) I FËMIJËVE dhe** **PJESËMARRJA AKTIVE E TYRE** **NË FAMILJE DHE NË SHOQËRI**

Fëmijët janë të barabartë dhe i kanë të njëjtat vlera, si të rriturit. Fëmijëria ka vlerë në vetvete. Ajo nuk është fazë, gjatë të cilës fëmijët përgatiten për fazat e mëvonshme të jetës së tyre.

Fëmijët janë të ndjeshëm dhe delikatë. Ata, prandaj, kanë nevojë për një përkujdesje të veçantë.

Përkujdesja për fëmijët dhe çdo vendim, nga kushdo qoftë, që merret për fëmijët, duhet të jetë në favor të interesave më të larta të tyre.

Në dobi të fëmijëve duhet të jenë:

- ligjet e miratuara ose korigjimi i tyre;
- rregulloret për trafikun,
- shëtoret dhe vendet për të lozur fëmijët;
- ndarja e buxheteve;
- zgjidhja e kontesteve private në jetën familjare;
- vendimi i gjykatave, etj.

Interesat e fëmijëve kanë përparësi, jo vetëm në ndërmarrjet publike dhe në institucionet shtetërore-publike, por edhe në ndërmarrjet dhe në institucionet private, që kanë të bëjnë me fëmijët.

Interesi më i lartë i fëmijëve është edukimi cilësor, zhvillimi i personalitetit individual të fëmijëve, i prirjeve dhe aftësive të tyre, duke marrë në konsideratë karakteristikat, interesat dhe nevojat e të nxënësve të tyre.

Programet mësimore (kurrikulat) duhet të kenë parasysh:

- kontestin social, kulturor, mjedisor dhe ekonomik të fëmijëve,
- nevojat e tyre, dhe
- potencialet zhvillimore të tyre.

Metodat mësimore duhet t'u përshtaten nevojave të ndryshme, të fëmijëve të ndryshëm.

Edukimi duhet të sigurojë aftësitë dhe shkathtësitë esenciale jetësore të secilit fëmijë, për t'u përballur me sfidat e ndryshme gjatë jetës së tyre:

- marrja e vendimeve të peshuara mirë;
- zgjidhja e konflikteve në mënyrë të padhunshme;
- raporte të mira sociale me të tjerët;
- përgjegjësia;
- mendimi kritik;

- prirjet kreative,
- kujdesi për shëndetin, etj.

Pra, edukimi duhet t'i aftësojë fëmijët për **jetë të përgjegjshme në shoqëri.**

Mësimi që **grumbullon dituritë** dhe që **ngarkon tepër fëmijët,** **pengon zhvillimin e fëmijëve, zhvillimin e aftësive dhe të prirjeve të tyre.**

Edukimi duhet të jetë **i këndshëm dhe miqësor** për fëmijët. Ai duhet t'i **inspirojë, t'i frymëzojë dhe t'i motivojë** fëmijët. Në qendër të tij duhet të jenë fëmijët.

Shkolla duhet të krijojë **një atmosferë humane** për fëmijët dhe duhet të krijojë kushte për **zhvillimin e potencialeve, të prirjeve dhe të aftësive të tyre.**

### **E DREJTA E FËMIJËVE PËR PJESËMARRJE AKTIVE NË FAMILJE, NË JETËN PUBLIKE DHE NË SHOQËRI, GARANTOHET ME KDF.**

**(Mos)pjesëmarrja e të rinjve, veçanërisht e adoleshentëve,** në shoqëri, është treguesi më i qartë **i (mos)demokratizimit** të një shoqërie.

Fëmijët janë persona **të aftë** dhe kanë të drejtë **të shpehin pikëpamjet e tyre për të gjitha çështjet,** sidomos për **ato çështje që prekin dhe që ndikojnë në jetën e tyre.**

Pikëpamjet e fëmijëve duhet **të dëgjohen** dhe atyre duhet **t'u jepet peshë,** në përputhje me **moshën dhe me pjekurinë e fëmijëve.**

Ata kanë **potencial:**

- të **pasurojnë procesin e vendimmarrjes;**
- të **pasurojnë këndvështrimet,** dhe
- të **marrin pjesë në ndryshime.**

**Respektimi i pikëpamjes së fëmijëve,** aftësisë së tij për të formuar dhe për të shprehur një mendim, mundëson **njohjen e interesit të vërtetë të fëmijëve.**

Pjesëmarrja aktive e fëmijëve në jetën shkollore:

- në **komunitetet shkollore** (letrarët, etj.);
- në **këshillat e nxënësve;**
- në **shkrimin e rregulloreve disiplinore të shkollës,** etj.

Pra, pikëpamjet, mendimet e fëmijëve duhet të **dëgjojen** dhe ato duhet të merren **seriozisht**.

Debat: **në ç'moshë** fëmijët duhet të kenë të drejtë **të kundërshtojnë** një birësim ose ndryshimin e emrit?

E drejta e fëmijëve për shprehjen e mendimit, përfshin:

- lirinë për **të kërkuar**,
- lirinë për **të marrë dhe përcjellë informacione dhe ide**: verbalisht, me shkrim, etj.

Fëmijët kanë edhe të **drjtën e besimit fetar**.

Shtetet-nënshkruese të KDF-së, garantojnë për fëmijët marrjen e **informacioneve dhe të materialeve**, nga **burime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare**:

- që rrisin **mirëqenien shoqërore, shpirtërore dhe morale të fëmijëve**,
- që **rrisin shëndetin e tyre fizik dhe mendor**, dhe
- që **i mbrojnë ata nga materialet e dëmshme**.

KDF-ja thekson pjesëmarrhen e fëmijëve edhe **në kohën e lirë, për lojëra, për rekreacion dhe aktivitete kulturore-artistike**.

E drejta e fëmijëve për pjesëmarrje, është **një përparim kualitativ**, në të drejtën e fëmijëve, që e ka ndryshuar **raportin e të rriturve ndaj fëmijëve**.

**Para të drejtës së fëmijëve për pjesëmarrje** aktive në familje dhe në shoqëri, fëmijët konsideroheshin **objekt, pronë e prindërve dhe e të rriturve. Tani, prindërit, mësuesit, kujdestarët** e fëmijëve, nuk janë furnizues dhe mbrojtës të fëmijëve, por **negociatorë, lehtësues apo ndihmues të fëmijëve**.

Të rriturit duhet të:

- **krijojnë hapësirë për fuqizimin e fëmijëve**,
- **të mundësojnë shprehjen e pikëpamjeve të tyre**,
- **të konsultohen me fëmijë, dhe**
- **të mundësojnë ndikimin e fëmijëve në vendimmarrje**.

OJQ-të kanë rol të madh në:

- **pjesëmarrjen e rinisë në aktivitetet e tyre**,
- **shprehjen e opinioneve të rinisë, dhe**
- **zhvillimin e aftësive të rinisë për pjesëmarrje në shoqëri**, etj.

Pjesëmarrja aktive e të rinjve në shoqëri, sigurohet me:

- **formimin e OJQ-ve rinore**, që ofrojnë **një platformë për të rinjtë** dhe që **ndërveprojnë me institucionet vendimmarrëse**, lokale dhe qëndrore;
- **përkrahjen e OJQ-ve dhe grupeve rinore** që merren kryesisht me **çështjet rinore**,
- **angazhimin e të rinjve në TV-të dhe radiot**, lokale dhe qëndrore, për: **këmbimin e diturive dhe përvojave të tyre**, **informatat për shëndetin, edukimin seksual, parandalimin e infektimit**, etj.

Kështu të rinjtë **do të besonin dhe do të ndjenin se kanë një zë për zhvillimin dhe prosperitetin e vendit të tyre**.

PYETJE:

1. Fëmijët dhe të rriturit:
  - a) kanë vlera të njëjta,
  - b) nuk kanë vlera të njëjta.
2. Përkujdesjet për fëmijët dhe vendimet që merren për fëmijët duhet të jenë:
  - a) në interes të fëmijëve,
  - b) në interes të prindërve të tyre,
  - c) në interes të shoqërisë.
3. Interesat e fëmijëve kanë përparësi:
  - a) vetëm në ndërmarrjet publike dhe në institucionet shtetërore,
  - b) edhe në ndërmarrjet dhe në institucionet private.
4. Ngarkimi i tepërt me mësimet e fëmijëve:
  - a) pengon zhvillimin e aftësive dhe prirjeve të fëmijëve,
  - b) ndihmon zhvillimin e aftësive dhe të prirjeve.
5. Pjesëmarrja e fëmijëve në shoqëri dhe demokratizimi i shoqërisë qëndrojnë në raport:
  - a) të drejtë,
  - b) të zhdrejtë.
6. Pikëpamjet e të rinjve duhet të merren në konsideratë, kur ato:
  - a) kanë të bëjnë me çështjet e gjithë shoqërisë,
  - b) kanë të bëjnë me çështjet e të rinjve.

7. Fëmijët e kanë të drejtën e besimit fetar:

- a) po,
- b) jo.

8. E drejta e fëmijëve për pjesëmarrje:

- a) e ka zgjeruar lirinë e fëmijëve, por e ka dobësuar ndikimin e prindërve mbi fëmijët, apo
- b) e ka kufizuar lirinë e fëmijëve, por e ka forcuar ndikimin e prindërve mbi fëmijët?

9. Në pjesëmarrjen e fëmijëve në shoqëri mund të ndihmojnë:

- a) .....
- b) .....
- c) .....
- d) .....